



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
DHOMA KOMBËTARE E NOTERISË

DEGA VENDORE TIRANË

NOTER JULIAN ZHELEGU
ADRESA Njesia Bashkiake nr. 5, Rr.
Pjeter Bogdani, Godina Nr. 13, Hyrja Nr.
2
TEL: 0682027818

KONTRATË SHITJE PASURI E LUAJTSHME

(KUOTA KAPITALI)

Nr. repertori: 7102

Nr. koleksioni: 2684

Tirane më 11/11/2020

Ligjet referuese:

- 1.Ligji nr. 7850, datë 29/07/1994 "Kodi Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar
- 2.Ligji nr. 9887, date 10/03/2008 "Për mbrojtjen e të dhënave personale", i ndryshuar
- 3.Ligji nr. 110, datë 20/12/2018 "Për Noterinë"

*Akti noterial përbëhet nga 3 fletë



A2020053950245144801



A2020053950087589694



KONTRATE SHITJE KUOTE

Ne Tirane, sot me date 11 / 11 / 2020 (dymijë e njëzet) përpara meje noter Julian Zhelegu, anëtar i Dhomës së Noterisë Tiranë, me seli në adresën Rr. "Pjeter Bogdani", nr. 13, u paraqitën personalisht palet kontraktuese si me poshtë:

SHITESI: Shoqëria European Education Initiative Holding shpk., një shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e themeluar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, regjistruar në Regjistrin Tregtar që administrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me NIPT/NUIS L61419036L, me seli të regjistruar në adresën, Bulevardi "Gjergj Fishta", Nr. 70, H. 1, Tirane, përfaqësuar nga Administratori i vetëm i saj, Betim Shkupi, shtetas shqiptar i datëlindjes 10.07.1984, lindur në Vlorë dhe banues në Tiranë, mbajtës i letërnjoftimit ID me nr. 033914576 dhe nr. Personal I40710088T, madhor me zotësi të plote juridike e për te vepruar, pa kufizime të kompetencave të perfaqesimit;

(ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Shitësi")

Dhe

BLERESI: Z. Henri Çili, i biri Sherifit, shtetas shqiptar, i datëlindjes 05.11.1975, lindur në Elbasan dhe banues në Tirane, mbajtës i Letërnjoftimit ID me nr. 030722484 dhe nr. personal H51105114N, madhor me zotësi të plote juridike e për te vepruar;

(ne vijim e për efekt të kësaj Kontrate referuar si "Blerësi")

Palët e mësipërme në vijim dhe për efekt të kësaj Kontrate, do të referohen individualisht si "Pale/a" dhe së bashku si "Pale/et".

MEQENESE:


A. Shitësi është ortak zotërues i një Kuote (Kuota) që përfaqëson 100% (njëqind përqind) të kapitalit të regjistruar të shoqërisë "European Education Initiative" sh.p.k (ne vijim "Shoqëria EEI"), shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS K62029010L, me objekt të saj ndër tjera: "...operimi në fushën e arsimit të lartë, kërkimit shkencor, konsulence, etj", kapitali themeltar i regjistruar i të cilës është në shumën ALL 12.500.000 (dymbëdhjetë milionë e pesëqindë mijë lekë), sikurse rezulton nga Ekstrakti i Regjistrin Tregtar lëshuar nga Qendra Kombëtare e Biznesit (kopje e Ekstraktit nga Regjistri Tregtar i bashkëlidhet kësaj Kontrate në formën e ANEKSIT A dhe përbën pjesë integrale të kësaj Kontrate).

B. Shoqëria EEI ka nën kontroll dhe zotëron 95.35% të aksioneve të Shoqërisë Klinika Shqiptare Sh.A., (këtu e në vijim shoqëria "Klinika Shqiptare") shoqëri tregtare aksionare, e krijuar e që funksionon në përputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit me Numër Unik Identifikimi NUIS J618240200, me seli në adresën Bulevardi Gjergj Fishta, në ambientet e Ish N.P.V Nr. 1 (kopje e Ekstraktit nga Regjistri Tregtar i bashkëlidhet kësaj Kontrate në formën e ANEKSIT A, i cili përbën pjesë integrale të kësaj Kontrate).

C. Shitësi dëshiron t'i shesë Blerësit një kuotë që përfaqëson 49 % (dyzetë e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë EEI.

D. Blerësi dëshiron të blejë 49 % (dyzetë e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë EEI të zotëruar nga Shitësi.

E. Shitja e Kuotës është autorizuar nëpërmjet vendimit bashkëlidhur të Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë EEIH dhe EEI (kopjet e vendimit i bashkëlidhet kësaj Kontrate në formën e ANEKSIT B);



F.Pas verifikimit te regjistrimeve ne RBS, rezulton se Kuota objekt kontrate është e barrësuar në favor të Bankës Credins, e cila nëpërmjet Deklaratës Noteriale me nr. 3156 rep, nr. 1176 kol, date 7.7.2020, ka dhënë pëlqimin për kalimin e kuotës sipas përeaktimeve te kësaj Kontrate (kopje e ekstraktit nga RBS dhe Deklaratës Noteriale i bashkëlidhen kësaj Kontrate në formën e ANEKSIT C).

G.Kjo Kontrate shërben për përcaktimin e kushteve, procedurave dhe mënyrës se transferimit te pronësisë dhe pagesave përkatëse lidhur me këtë transferim. Palët konsiderojnë te ligjshme përmbajtjen e kësaj Kontrate dhe marrin përsipër te ekzekutojnë përcaktimet e saj.

PER SA ME SIPER, Palët ranë dakord për te lidhur këtë Kontrate Shitje Kuote.

NENI 1 OBJEKTI

1.1. Objekt i kësaj kontrate është kalimi i pronësisë nga Shitësi tek Blerësi i Kuotës qe përfaqëson 49 % (dyzetë e nëntë përqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë "European Education Initiative" sh.p.k.sipas kushteve dhe përcaktimeve te parashikuara ne këtë Kontrate.

1.2. Shitja ne masën 49 % (dyzetë e nëntë përqind) te kuotave te kapitalit te Shoqërisë "European Education Initiative" sh.p.k, sjell për Shitësin humbjen e se drejtës te pronësisë ne masën 49 % (dyzetë e nëntë përqind).

NENI 2 ÇMIMI DHE MENYRA E PAGESËS

2.1. Çmimi i shitjes se Kuotës që përfaqëson 49 % (dyzetë e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë EEI është EUR 49.000 (dyzetë e nëntë mijë) euro. Çmimi i shitjes do te paguhet i plotë, në llogarinë bankare të Shitësit pranë bankës Credins, jo më vonë se 12 (dymbëdhjetë) muaj nga data e nënshkrimit të kësaj kontrate. Mandati bankar i pagesës do t'i bashkëlidhet kësaj Kontrate.

2.2. Çmimi i shitjes gjendet i drejte dhe i arsyeshëm, dhe është dakordësuar edhe duke pasur parasysh gjendjen financiare të shoqërisë EEI, përfshirë detyrimet e saj ndaj të tretëve dhe per te cilat Bleresi dhe Shitesit do te perpjigjen në përputhje me parashikimet ligjore në fuqi. Palët garantojnë se me nënshkrimin e kësaj Kontrate nuk do te kenë asnjë pretendim te çfarëdo lloji aktual apo te ardhshem ne lidhje me çmimin e shitjes dhe shprehimisht heqin dore përfundimisht nga çdo pretendim dhe/ose rezerve dhe/ose nga cdo e drejte per te ngritur padi ne lidhje me shumen e çmimit te shitjes te përcaktuar ne këtë Kontrate.

NENI 3 KALIMI I PRONËSISË MBI KUOTËN

3.1. Pronësia mbi Kuotën qe përfaqëson 49 % (dyzetë e nëntë përqind)te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë do te kaloje nga Shitësi te Blerësi me nënshkrimin e kësaj Kontrate, e cila do të regjistrohet menjëherë në librat e Shoqërisë si dhe në Regjistrin Tregtar sipas ligjit. Palët shprehimisht njohin, pranojnë dhe vërtetojnë se pronësia mbi Kuotën kalon ne momentin e nënshkrimit te kësaj Kontrate, pavarësisht kohës së përmbushjes se detyrimit te Blerësit për pagimin e çmimit te shitjes sipas përcaktimeve me sipër.

3.2. Palët konfirmojnë se struktura e zotërimit te kapitalit te Shoqërisë EEI, me lidhjen e kësaj Kontrate, do te jete si vijon:

1. Z. Rudin Dura zotërues i 1 (një) që përfaqëson zotëron 51 % (pesëdhjetë e një përqind) të kapitalit të Shoqërisë EEI.

2.Z. Henri Çili zotërues i 1 (një) kuote që përfaqëson 49 % (dyzet e nëntë përqind) të kapitalit të Shoqërisë EEI.

NENI 4 DEKLARATA DHE GARANCI

4.1. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se:

a. Shitësi është zotëruesi i vetëm i 49% (dyzete e nëntë përqind) te kapitalit te regjistruar te Shoqërisë EEI dhe ai gëzon gjithë te drejtat e votës dhe çdo te drejte tjetër qe rrjedh nga Kuota dhe ka tagra te plota për te shitur Kuotën e zotëruar prej tij.

b. Shoqëria EEI është një shoqëri tregtare me përgjegjësi te kufizuar, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, ne përmbushje te objektit te saj tregtar dhe se nuk ka asnjë pengese te asnjë lloji për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.



c. Shoqëria EEI nuk është ne proces likuidimi apo falimentimi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë kërkesë për likuidim/faliment dhe ne baze te rezultateve te saj nuk parashikohet te cenohet ekzistenca e saj nga asnjë procedure likuidimi / falimenti / administrimi te detyrueshëm, etj.

d. Kuota është e lire nga çdo barre a peng apo e drejte-tjetër e të tretëve qe do te pengonin transferimin e lirshëm sipas kësaj Kontrate, përveç barrës siguroese te regjistruar ne favor te Credins Bank sh.a. e cila do te vazhdoje te qendroje ne fuqi mbi 100% te kuotave te shoqërise EEI, si kunder parashikuar edhe ne deklaraten e leshuar nga Banka Credins sha si bashkelidhur kesaj kontrate.

e. Aktivet e zotëruara nga Shoqëria EEI janë ne pronësinë e saj te plote dhe ligjore dhe titujt e pronësisë dhe te drejtat reale te Shoqërisë nuk cenohen nga asnjë pretendim i asnjë pale te trete dhe Shoqëria nuk ka detyrime ndaj te tretëve veç atyre qe pasqyrohen ne librat dhe regjistrimet kontabël te Shoqërisë.

f. Shoqëria Klinika Shqiptare Sh.A. është një shoqëri tregtare aksionare, e krijuar e qe funksionon ne përputhje me legjislacionin shqiptar, ne përmbushje te objektit te saj tregtar dhe se nuk ka asnjë pengese te asnjë lloji për ushtrimin e veprimtarisë tregtare.

g. Shoqëria Klinika Shqiptare Sh.A nuk është ne proces likuidimi apo falimentimi dhe ndaj saj nuk ka ndonjë kërkesë për likuidim/faliment dhe ne baze te rezultateve te saj nuk parashikohet te cenohet ekzistenca e saj nga asnjë procedure likuidimi / falimenti / administrimi te detyrueshëm etj.

Aktivitetet e zotëruara nga Klinika Shqiptare Sh.A janë ne pronësinë e saj te plote dhe ligjore dhe titujt e pronësisë dhe te drejtat reale te Shoqërisë nuk cenohen nga asnjë pretendim i asnjë pale te trete dhe Shoqëria nuk ka detyrime ndaj te tretëve veç atyre qe pasqyrohen ne librat dhe regjistrimet kontabël te Shoqërisë.

h. Shitësi shprehimisht deklaron e garanton Blerësin se gjendja financiare e Shoqërisë EEI dhe Klinika Shqiptare Sh.A. është ajo qe pasqyrohet ne bilancet e miratuara e te publikuara te shoqërive dhe se gjendja aktuale e Shoqërive është ajo qe pasqyrohet ne Bilancet e secilës bashkelidhur kësaj Kontrate ne formën e ANEKSIT D, i cili përbën pjese integrale te kësaj Kontrate.

i. Kapitali i Shoqërisë EEI është nënshkruar dhe paguar plotësisht.

j. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Shitësi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Shitësi është palë.

k. Shitësi deklaron dhe garanton Blerësin se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime ne datën e nënshkrimit.

l. Me lidhjen e kësaj Kontrate, Shitësi garanton Blerësin se do t'i siguroje atij kontrollin efektiv te Shoqërisë në përputhje me te drejtat qe rezultojnë nga zotërimi i Kuotës.

4.2. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësin se:

a. Blerësi ka tagra te plota për të blerë Kuotën sipas kushteve dhe afateve te kësaj Kontrate.

b. Blerësi do të paguajë menjëherë çmimin e shitjes sipas përcaktimeve te nenit 2 te kësaj Kontrate.

c. Blerësi është njohur, ka dijeni dhe pranon gjithë dokumentacionin e themelimit, atë administrativ, teknik, financiar dhe kontraktual te Shoqërisë që Shitësi i ka vendosur në dispozicion përpara lidhjes se kësaj Kontrate.

d. Nënshkrimi apo zbatimi i kësaj Kontrate nga Blerësi, nuk vjen ne kundërshtim me ligjet, Statutin, kontratat, marrëveshjet apo dokumentet e tjera ligjore ne te cilat Blerësi është palë.

e. Blerësi deklaron dhe garanton Shitësit se deklarimet dhe garancitë e dhëna sipas kësaj Kontrate janë te vërteta, te sakta dhe nuk përmbajnë keqinformime ne datën e nënshkrimit.

4.3. Palët garantojnë se kjo Kontrate përben detyrim ligjor, te vlefshëm, te detyrueshëm dhe te pashmangshëm për Shitësin dhe Blerësin dhe çdo pasues te tyre te mundshëm, qofte ne vije trashëgimore, si dhe ne rast pjesëtimit pasurie bashkëshortore dhe ose ne çdo shtet tjetër duke i qëndruar vetëm qëllimit qe i ka paraprirë palët ne lidhjen e kësaj Kontrate.

4.4. Palët detyrohen te mbajnë konfidencial te gjithë dokumentacionin, te dhënat dhe çdo informacion tjetër konfidencial te përfutur gjate marrëdhënies se tyre ne Shoqëri.

Neni 5

EFEKTET E KONTRATËS


5.1. Kjo Kontrate hyn ne fuqi me nënshkrimin e saj përpara noterit dhe mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim te palëve.

5.2. Kontrata ka efekt për palët e treta ne përputhje me dispozitat ligjore.

Neni 6

DISPOZITA TË FUNDIT

6.1. Kjo Kontrate përmban marrëveshjen e plote ndërmjet palëve ne lidhje me objektin e përcaktuar këtu



dhe zëvendëson të gjitha marrëveshjet e mëparshme, me gojë apo me shkrim, ndërmjet Palëve, në lidhje me objektin e kësaj Kontrate.

6.2. Kjo Kontratë do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e Ligjit Nr.9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, dhe Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë.

6.3. Çdo konflikt apo mosmarrëveshje që lidhet me hartimin, interpretimin apo zbatimin e kësaj Kontrate, që nuk mund të zgjidhet me mirëkuptim ndërmjet Palëve, do të zgjidhet nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

Kontratës i bashkëlidhen:

Kopje të dokumenteve të identifikimit dhe përfaqësimit të Palëve dhe:

Aneksi A (Ekstrakt nga Regjistri Tregtar i Shoqërisë)

Aneksi B (Vendimet e Asamblesë së Ortakeve të Shoqërisë)

Aneksi C (Ekstrakt nga Regjistri i Barrëve Siguruese dhe Deklarata me nr. 3156 rep, nr. 1176 kol, datë 7.7.2020 e Bankës Credins) dhe

Aneksi D (Bilanci i gjendjes aktuale të Shoqërisë, European Education Initiative Sh.P.K., dhe Klinika Shqiptare Sh.A.).

Kontrata perpilohet në 4 origjinale të njëjta në gjuhën shqipe me vlerë të barabartë secila. Une, Noteri, pasi ua lexova me ze të lartë Palëve këtë kontratë, dhe u sigurova për identitetin e tyre, konstatova se ata e gjejnë atë të rregullt në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe të plote, e nënshkruajnë dhe Une noteri e vertetoj atë sipas ligjit.

SHITËSI

Shoqëria European Education Initiative Holding shpk

Perfaqësuar nga Administratori

Betim Shkupi

Betim Shkupi



BLERËSI
Henri Çili

Henri Çili

NOTERI
JULIAN ZHELEGU

Julian Zhegu